



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 33 14 – 20 Gusht 2023

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 NJVKSH ose 100% (=36/36) e tyre

33 NJVKSH ose 91% (=36/36) e tyre kanë raportuar në platformën dixhitale SISI:

BERAT, BULQIZË, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIË, KUÇOVË, KUKËS, KURBIN, LEZHË, LIBRAZH, LUSHNJË, MALLAKASTËR, M. MADHE, MAT, MIRDITË, PEQIN, PËRMET, POGRADEK, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, 3 NJVKSH ose 3% (=9/36) e tyre: DEVOLL, HAS, TROPOJË

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 33

| | JAVA 33 |
|---|---------------|
| DIARRE PA GJAK | 3.632 |
| DIARRE ME GJAK | 0 |
| INF. RESP. TE SIPËRME | 5.537 |
| INF. RESP. TE POSHTËME | 2.058 |
| RASH ME TEMPERATURË | 7 |
| VERDHEZA | 0 |
| ETHE E ZGJATUR E PASHPJEGUAR (> 3 JAVE) | 0 |
| ANOMALI KONGENITALE | 0 |
| KONJUKTIVIT AKUT TEK NEONATËT | 0 |
| Numri i Njësive Raportuese | 404 |
| % e Njësive Raportuese | 91% (404/446) |

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë dhe dorë-këmbë-gojë:


Fier – 3 raste

Kukës – 3 raste


Tiranë –1 rast

Infeksione respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet 8% ritje në javën 33 krahasuar me javën paraardhëse, java 32.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet ritje në javën 33 krahasuar me javën paraardhëse, java 32.

Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 25 - 33 të vitit 2022 dhe 2023. Numri i rasteve.




Në javën 33 të vitit 2023 vërehet prirje në ritje e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.

Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 32 dhe 33 / 2023. Incidenca (raste/10.000)




Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët 25 - 33 të vitit 2022 dhe 2023. Numri i rasteve.



Në javën 33 të vitit 2023 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 32 dhe 33 / 2023. Incidenca (raste/10.000)



Nga komunikimi me NJVKSH shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Ngjarje ndërkombëtare

1. *Survejanca sezonale e virusit të Nilit Perëndimor - 2023*

- Tridhjetë e gjashtë raste në njerëz të infeksionit me virusin e Nilit Perëndimor (WNV) janë raportuar nga vendet e BE/EEA, dhe nëntë nga vendet fqinje me BE-në që nga përditësimi i fundit, dhe që nga 16 gushti 2023.
- Që nga fillimi i sezonit të transmetimit 2023, 125 raste humane të infeksionit WNV janë raportuar nga vendet e BE/EEA, dhe 24 nga vendet fqinje të BE-së.
- Tetë shpërthime midis ekuidëve dhe 47 shpërthime midis shpendëve janë raportuar nga vendet e BE/EEA, që nga fillimi i sezonit të transmetimit të WNV 2023, dhe që nga 16 gushti 2023

2. *Poliomieliti – Monitorimi i shpërthimeve globale*

- Më 3 maj 2023, Komiteti i Emergjencës për Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit për Polio (IHR) deklaroi, se rreziku i përhapjes ndërkombëtare të poliovirusit mbetet një Emergjencë e Shëndetit Publik me shqetësim ndërkombëtar (PHEIC), dhe rekomandoi zgjatjen e Rekomandimeve të Përkohshme për tre muaj të tjerë.
- Që nga përditësimi i fundit, në vitin 2023, në Pakistan është raportuar një rast i ri i paralizës flakside akute (AFP) të shkaktuar nga WPV1.
- Që nga përditësimi i fundit, dy vende të reja kanë raportuar raste të AFP të shkaktuara nga cVDPV2: Burundi (1) dhe Guinea (1).
- Në vitin 2023, dhe që nga 15 gushti 2023, njëmbëdhjetë raste të reja të AFP të shkaktuara nga cVDPV1 janë raportuar nga DRC (11).

3. *Rastet e etheve hemorragjike Kongo-Krime në Maqedoninë e Veriut, korrik-gusht 2023*

- Më 14 gusht, Instituti i Shëndetit Publik në Maqedoninë e Veriut informoi për një rast të etheve hemorragjike Kongo-Krime (CCHF), që supozohet se është infektuar nga pickimi i rriqnës.
- Kjo nuk ka të bëjë me rastin fatal të CCHF të raportuar më herët, i ekspozuar edhe nga pickimi i rriqnës, i cili ka rezultuar në një transmetim dytësor në mjedisin shëndetësor.

Ngjarje kombëtare

4. *Rast i konfirmuar me Antraks, Gjirokastër*

Rasti është femër e moshës 40 vjeç, me banim të përkohshëm në fshatin Picar, por me banim të përhershëm në Greqi (Athinë) paraqitet në datën 18 gusht 2023, pranë urgjencës së spitalit me një puçër me pikë të zezë në dorën e majtë.

Pas kryerjes së testimit në datë 18 gusht 2023 me metodën mikroskopi e drejtpërdrejtë me ngjyrim, mostra rezultoi pozitive për Antraks.

Nga hetimi epidemiologjik në vatër nga shërbimi, rasti përveçse ka konsumuar mish të viçit të therur, por të gatuar mirë në Picar, ka pasur kontakt me të brendshmet e bagëtive të sapotherura në fshatin Bajkaj, Delvinë në datë 14 gusht 2023.

Është komunikuar me shërbimin veterinar pranë bashkisë Gjirokastrë për kryerjen e analizave të mishit të viçit, si edhe hetimin nga ana e shërbimit veterinar.

Përfundime

- Duke ditur që periudha e inkubacionit të antraksit është nga 3-7 ditë, mendohet se pacientja është infektuar në Bajkaj gjatë kontaktit me të brendshmet e bagëtive të therura.
- Priten përgjigjet e analizave të mishit nga shërbimi veterinar në Gjirokastrë.
- Mjeku i familjes do të monitorojë në vazhdimësi anëtarët e tjerë të familjes që konsumuan mishin në Picar. Aktualisht, asnjë prej tyre nuk ka paraqitur shenja klinike.
- Të dhënat e rastit janë regjistruar në SISI, është lajmëruar ISHP-ja dhe shërbimi epidemiologjik në Ministrinë e Bujqësisë.